



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.201

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 035 datë 22.12.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Kombeve të Bashkuara “Për arrestimin e anijeve, 1999”	10893
Ligj nr.10 036 datë 22.12.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe vendore”	10900
Ligj nr.10 037 datë 22.12.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve Europiane “Për bashkëprodhimet kinematografike” ..	10905
Ligj nr.10 038 datë 22.12.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për taksimin e mjeteve rrugore në transportin ndërkombëtar të mallrave	10921

LIGJ
Nr.10 035, datë 22.12.2008

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E KOMBEVE TË
BASHKUARA “PËR ARRESTIMIN E ANIJEVE, 1999”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën e Kombeve të Bashkuara “Për arrestimin e anijeve, 1999”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5993, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA
NDËRKOMBËTARE PËR ARRESTIMIN E ANIJEVE 1999
KOMBET E BASHKUARA
1999

Shtetet Palë në këtë Konventë,
duke njohur dëshirën për lehtësimin e zhvillimit harmonik dhe të rregullt të tregtisë detare botërore;

të bindur për domosdoshmërinë e një instrumenti ligjor që përcakton uniformitetin ndërkombëtar në fushën e arrestimit të anijeve, i cili merr parasysh zhvillimet e fundit në fushat që lidhen me të,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. "Pretendim detar" do të thotë një pretendim që lind prej njëres ose disave nga pikat e mëposhtme:

- a) humbjen ose dëmtimin e shkakuar nga përdorimi i anijes;
- b) humbjen e jetës ose plagosjen personale që ndodh si në tokë edhe në ujë, në lidhje të drejtpërdrejtë me operimin e anijes;
- c) operacionet e shpëtimit apo ndonjë marrëveshje shpëtimi, që përfshin, kur aplikohet, kompensimin e veçantë për sa i përket operacioneve të shpëtimit në lidhje me një anije, e cila vetë ose ngarkesa e saj, kërcënonte dëmtimin e mjedisit;

d) dëmin ose kërcënimin për dëm të shkakuar nga anija në mjedis, vijën bregdetare ose interesat e lidhura me to; masat e marra për të parandaluar, minimizuar ose për të larguar një dëm të tillë; kompensimi për këtë dëm; kostot e masave të arsyeshme për kthimin e mjedisit në gjendjen e

mëparshme që faktikisht janë marrë ose do të merren; humbja e ndodhur ose që mund të ndodhë nga palë të treta në lidhje me këtë dëm; dhe dëmi, kostot ose humbja e një natyre të ngjashme për ata që identifikohen në këtë nënparagraf (d);

e) kostot ose shpenzimet që lidhen me ngritjen, heqjen, rregullimin, shkatërrimin ose ruajtjen nga dëmi të një anijeje e cila është fundosur, shkatërruar, braktisur ose ka humbur drejtimin, duke përfshirë çdo gjë që është ose ka qenë në këtë anije dhe kostot ose shpenzimet që lidhen me ruajtjen e një anijeje të braktisur dhe mirëmbajtjen e ekuipazhit të saj;

f) çdo marrëveshje që lidhet me përdorimin ose marrjen me qira të një anijeje kur kjo është në një kontratë apo në një mënyrë tjetër;

g) çdo marrëveshje që lidhet me transportin e mallrave apo pasagjerëve në anije, si kur palë e marrëveshjes është një kontratë apo në një mënyrë tjetër;

h) humbjen ose dëmtimin e mallrave ose humbja apo dëmtimi që lidhet me to (duke përfshirë bagazhin) që mbartet në anije;

i) një avari të përgjithshme;

j) rimorkimin;

k) pilotimin;

l) mallrat, materialet, furnizimet, bunkerët, pajisjet (duke përfshirë kontenierët) që furnizohen ose shërbimet që i kryhen një anijeje për operimin e saj, menaxhimin, ruajtjen ose mirëmbajtjen e saj;

m) ndërtimin, rindërtimin, riparimin, konvertimin ose pajisjen e anijes;

n) pagesat dhe detyrimet e tjera për portin, kanalin, molin, skelën dhe rrugë të tjera ujore;

o) rrogat dhe shumat e tjera që u duhen paguar, kapitenit, oficerëve dhe anëtarëve të tjerë të anijes në lidhje me punësimin në anije, duke përfshirë kostot e riatdhesimit dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore që duhen paguar në emër të tyre;

p) disbursimet që kryhen në emër të anijes ose pronarëve të saj;

q) primet e sigurimit (duke përfshirë telefonatat për sigurimet reciproke) në lidhje me anijen, që duhen paguar në emër të pronarit të anijes ose marrësit me qira;

r) çdo komision, pagesë për ndërmjetësi ose për një agjenci që duhen paguar në lidhje me anijen nga ose me emër të pronarit të anijes ose marrësit charterit;

s) çdo mosmarrëveshje në lidhje me pronësinë ose zotërimin e anijes;

t) çdo mosmarrëveshje ndërmjet bashkëpronarëve të anijes në lidhje me punësimin ose fitimet nga anija;

u) një hipotekë apo një detyrim i së njëjtës natyrë për anijen;

v) çdo mosmarrëveshje që lind nga një kontratë për shitjen e anijes.

2. "Arrest" do të thotë çdo ndalim apo kufizim për heqjen e anijes me urdhër të një gjykate për të siguruar një pretendim detar, por që nuk përfshin sekuestrimin e një anijeje në ekzekutim ose përmbushje të një gjykimi ose një instrumenti tjetër të zbatueshëm.

3. "Person" do të thotë çdo individ apo autoritet, apo organ publik apo privat, qoftë shoqëri apo jo, duke përfshirë një shtet ose ndonjë prej nënndarjeve të tij përbërës.

4. "Pretendues" do të thotë një person që ngre një pretendim detar.

5. "Gjykatë" do të thotë çdo autoritet kompetent gjyqësor i një shteti.

Neni 2

Të drejtat e arrestimit

1. Një anije mund të arrestohet ose të lirohet nga arresti vetëm me autoritetin e një gjykate të shtetit palë në të cilën është kryer arresti.

2. Një anije mund të arrestohet vetëm në lidhje me një pretendim detar, por për asnjë pretendim tjetër.

3. Një anije mund të arrestohet për qëllimin e përfitimit të sigurisë pavarësisht se me anë të një klauzole juridiksioni ose një klauzole arbitrazhi në ndonjë kontratë përkatëse apo ndonjë dokument tjetër, pretendimi detar në lidhje me të cilin është kryer arresti duhet të gjykohet në një shtet tjetër nga shteti ku u krye arresti, ose do t'i arbitrohet ose do t'i nënshtrohet gjykimit të ligjit të një shteti tjetër.

4. Duke iu nënshtuar dispozitave të kësaj Konvente procedura që lidhet me arrestin e një anijeje ose lirimin e saj do të rregullohet nga ligji i shtetit, në të cilën u krye apo u aplikua arresti.

Neni 3
Ushtrimi i së drejtës së arrestit

1. Arresti lejohet për çdo anije në lidhje me të cilën ngrihet një pretendim detar, në qoftë se:
 - a) personi që ka në pronësi anijen, në kohën kur ngrihet pretendimi detar është përgjegjës për pretendimin dhe pronari i anijes kur kryhet arresti; ose
 - b) marrës me kontratë charter i anijes në kohën kur ngrihet pretendimi detar është përgjegjës për pretendimin dhe është kontraktuesi me qira apo pronari i anijes kur është kryer arresti; ose
 - c) pretendimi bazohet tek një "hipotekë" ose një detyrim i të njëjtës natyrë për anijen; ose
 - d) pretendimi lidhet me pronësinë ose zotërimin e anijes; ose
 - e) pretendimi është kundër pronarit, kontraktuesit me qira, menaxherit ose operuesit të anijes dhe sigurohet me anë të një nga një barrë detare, e cila jepet ose lind sipas ligjit të shtetit ku është aplikuar arresti.
2. Arresti lejohet, gjithashtu për çdo anije tjetër që, kur kryhet arresti, është pronë e personit që është përgjegjës për pretendimin detar dhe, i cili, kur u ngrit pretendimi ishte:
 - a) pronari i anijes në lidhje me të cilën u ngrit pretendimi; ose
 - b) kontraktues me qira, marrës me qira i përkohshëm ose kontraktues i udhëtimit i një anijeje.Kjo dispozitë nuk zbatohet për pretendimet në lidhje me pronësinë apo zotërimin e një anijeje.
3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, arrestimi i një anijeje, e cila nuk është pronë e një personi që është përgjegjës për pretendimin, do të lejohet vetëm në qoftë se, sipas ligjit të shtetit ku është aplikuar arresti, mund të zbatohet kundër asaj anijeje një vendim në lidhje me atë pretendim me anë të një shitjeje gjyqësore ose të detyruar të asaj anijeje.

Neni 4
Lirimi nga arresti

1. Një anije që është arrestuar do të lirohet kur është dhënë një siguri e mjaftueshme në formë të kënaqshme, me përjashtim të rasteve në të cilat një anije është arrestuar në lidhje me ndonjë pretendim detar të renditur në nenin 1 paragrafi 1 (s) dhe (t). Në këto raste gjykata mund ta lejojë personin që zotëron anijen që të vazhdojë tregtinë me anijen, duke dhënë ky person siguri të mjaftueshme, ose mund të merret me përdorimin e anijes në një mënyrë tjetër gjatë periudhës së arrestit.
2. Në mungesë të marrëveshjes midis palëve në lidhje me mjaftueshmërinë dhe formën e sigurisë, gjykata do të përcaktojë natyrën dhe shumën e saj, duke mos kaluar vlerën e anijes së arrestuar.
3. Çdo kërkesë për lirim të anijes me anë të sigurimit që jepet nuk do të konceptohet si një njohje e përgjegjësisë ose si një heqje dorë nga mbrojtja apo e drejta për të kufizuar përgjegjësinë.
4. Në qoftë se një anije është arrestuar në një shtet jo palë dhe është liruar, megjithëse është dhënë siguria në lidhje me atë anije në shtetin palë për të njëjtin pretendim, ajo siguri do të urdhërohet që të lirohet me kërkesë drejtuar gjykatës në shtetin palë.
5. Në qoftë se në një shtet jo palë anija lirohet me sigurinë e kënaqshme në lidhje me atë anije, çdo siguri e dhënë në shtetin palë në lidhje me të njëjtin pretendim do të urdhërohet deri në masën që shuma totale e sigurisë së dhënë në të dy shtetet kalon:
 - a) pretendimin për të cilin është arrestuar anija; ose
 - b) vlerën e anijes,cilado qoftë më e ulët. Megjithatë, ky lirim nuk do të urdhërohet, po qe se siguria e dhënë në shtetin jo palë nuk do të bëhet e disponueshme faktikisht për pretenduesin dhe nuk do të jetë lirisht e transferueshme.
6. Aty ku, sipas paragrafit 1 të këtij neni, është dhënë siguria, personi që jep këtë siguri, në çdo kohë mund t'i kërkojë gjykatës që t'i reduktohet, modifikohet ose anulohet kjo siguri.

Neni 5
E drejta e riarrestit dhe arresteve të shumta

1. Kur në ndonjë shtet është arrestuar tashmë një anije dhe është lëshuar ose është dhënë në lidhje me atë anije një siguri tashmë për të siguruar një pretendim detar, kjo anije pas kësaj nuk do të riarrestohet ose arrestohet në lidhje me të njëjtin pretendim detar me përjashtim të rastit kur:

a) natyra ose shumta e sigurisë në lidhje me atë anije e dhënë tashmë për të njëjtin pretendim është e papërshtatshme, me kushtin që shumta e përgjithshme e sigurisë të mos e kalojë vlerën e anijes; ose

b) personi i cili tashmë e ka dhënë sigurinë nuk do të jetë në gjendje që të përmbushë disa ose të gjitha detyrimet e atij personi; ose

c) anija e arrestuar ose siguria e dhënë më parë është liruar; ose

i) me aplikimin ose me pëlqimin e pretenduesit duke vepruar mbi shkaqe të arsyeshme;

ii) sepse pretenduesi nuk mundëj, nëpërmjet hapave të arsyeshëm, ta parandalonte lirimin.

2. Çdo anije tjetër që në një mënyrë tjetër do t'i nënshtrohej arrestimit në lidhje me të njëjtin pretendim detar nuk do të arrestohet me përjashtim të rastit kur:

a) natyra ose shumta e sigurisë tashmë të dhënë në lidhje me të njëjtin pretendim është e papërshtatshme; ose

b) kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 (b) ose (c) të këtij neni.

3. "Lirimi" për qëllimin e këtij neni nuk do të përfshijë ndonjë lirim ose largim të paligjshëm nga arresti.

Neni 6

Mbrojtja e pronarëve dhe çartuesve *demise/bare boat* të anijeve të arrestuara

1. Si kusht për arrestimin e një anijeje ose për lejimin e një arresti tashmë të kryer që duhet mbajtur, gjykata mund t'i vendosë pretenduesit që kërkon të arrestojë ose që ka prokuruar arrestimin e anijes detyrimin që të japë sigurinë e një lloji dhe për një shumë dhe me këto kushte, siç mund të përcaktohet nga gjykata për ndonjë humbje që mund të kryhet vetë si rezultat i arrestit, për të cilën pretenduesi mund të konstatohet se është përgjegjës, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në këtë humbje, siç mund të kryhet ajo nga i pandehuri si pasojë e:

a) një arrestimi të gabuar ose të pajustificuar; ose

b) kur është kërkuar dhe është dhënë një siguri e tepërt.

2. Gjukata e shtetit në të cilin është kryer një arrest duhet të ketë juridiksionin për të përcaktuar masën e përgjegjësisë, në qoftë se ka, të pretenduesit për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar nga arrestimi i një anijeje, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te ky dëm, siç mund të shkaktohet si pasojë:

c) e një arrestimi të gabuar ose të pajustificuar; ose

d) kur është kërkuar dhe është dhënë një siguri e tepërt.

3. Përgjegjshmëria, nëse ka, e pretenduesit, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, do të përcaktohet me zbatimin e ligjit të shtetit ku është kryer arresti.

4. Nëse gjykata në një shtet tjetër ose në një gjykatë arbitrazhi do të përcaktojë themelin e çështjes në përputhje me dispozitat e nenit 7, atëherë procedimet në lidhje me përgjegjësinë e pretenduesit, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni mund ta mbajnë atë vendim pezull.

5. Aty ku është dhënë siguria sipas paragrafit 1 të këtij neni, personi që e jep këtë siguri në çdo kohë mund t'i drejtohet gjykatës që t'i reduktohet, modifikohet ose anulohet kjo siguri.

Neni 7

Juridiksioni për themelin e çështjes

1. Gjykatat e shtetit në të cilin është kryer një arrest apo është dhënë një siguri për të përfituar lirimin e anijes do të kenë juridiksionin për të përcaktuar çështjen sipas themelit të çështjes, me përjashtim të rastit kur palët kanë rënë dakord në mënyrë të vlefshme për të paraqitur mosmarrëveshjen në një gjykatë të një shteti tjetër, i cili e pranon juridiksionin ose në një arbitrazh.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, gjykatat e shtetit në të cilin është kryer arresti ose dhënë siguria për të përfituar lirimin e anijes, mund të refuzojnë ushtrimin e atij juridiksioni ku është lejuar ky refuzim nga ligji i atij shteti dhe një gjykatë e një shteti tjetër pranon juridiksionin.

3. Në rastet kur një gjykatë e shtetit ku është kryer arresti ose ku është dhënë siguria për të përfituar lirin e anijes:

a) nuk e ka juridiksionin për të vendosur mbi çështjen sipas themelit; ose
b) ka refuzuar të ushtrojë juridiksionin në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, kjo gjykatë, me kërkesë, mund dhe do të urdhërojë një periudhë kohe brenda të cilës pretenduesi do të paraqesë çështjen para një gjykate kompetente ose një gjykate arbitrazhi.

4. Nëse çështja nuk sillet brenda periudhës kohore të urdhëruar, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, atëherë anija e arrestuar ose siguria e dhënë me kërkesë, do të urdhërohet që të lirohet.

5. Në qoftë se çështja sillet brenda periudhës kohore të urdhëruar, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ose nëse çështja para një gjykate kompetente ose një gjykate arbitrazhi me një shtet tjetër sillet në mungesë të një urdhri të tillë, çdo vendim i formës së prerë që rezulton prej tyre do të njihet dhe do të hyjë në fuqi në lidhje me anijen e arrestuar ose sigurinë e dhënë në mënyrë që të përfitohet lirimi i saj, me kushtin që:

c) të pandehurit t'i jetë bërë njoftim i arsyeshëm për këtë proces dhe i është dhënë një rast i arsyeshëm për të paraqitur çështjen për mbrojtje; dhe

d) kjo njohje nuk është kundër politikës publike (rendit publik).

6. Asgjë nga dispozitat që përmban paragrafi 5 i këtij neni nuk do të kufizojë më tej fuqinë e dhënë një gjykimi të huaj apo një arbitrazhi, sipas ligjit të shtetit ku është kryer arresti i anijes, apo është vënë siguria për të përfituar lirin e saj.

Neni 8

Aplikimi

1. Kjo Konventë do të aplikohet për çdo anije brenda juridiksionit të secilit shtet palë, qoftë kur kjo anije mban flamurin e shtetit palë apo jo edhe kur e mban flamurin e shtetit palë.

2. Kjo Konventë do të aplikohet për çdo anije luftarake, anije ndihmëse apo anije të tjera që zotërohen ose operohen nga një shtet dhe që përdoren, në një kohë të caktuar, vetëm për shërbime qeveritare jekomerciale.

3. Kjo Konventë nuk ndikon në asnjë të drejtë apo pushtet që ka një qeveri apo departamentet e saj apo ndonjë autoritet publik, apo ndonjë skelë, apo ndonjë autoritet portual, sipas ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare, apo sipas ndonjë ligji, apo rregulloreje të brendshme, për të ndaluar apo parandaluar në një mënyrë tjetër lundrimin e ndonjë anijeje tjetër brenda juridiksionit të tyre.

4. Kjo Konventë nuk do të ndikojë në të drejtën e ndonjë shteti apo gjykate për të lëshuar urdhra që ndikojnë në tërësinë e aseteve të një debitori.

5. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në zbatimin e konventave ndërkombëtare që parashikojnë kufizimin e përgjegjësisë ose ligjin e brendshëm që u jep atyre fuqi, në shtetin ku është kryer arresti.

6. Asgjë në këtë Konventë nuk do të modifikojë apo ndikojë në rregullat e ligjit në fuqi në shtetet palë në lidhje me arrestimin e një anijeje fizikisht brenda juridiksionit të shtetit të flamurit të saj të prokuruar nga një person, rezidenca e zakonshme e të cilit, ose selia kryesore e biznesit të të cilit është në atë shtet, ose nga një person tjetër, i cili ka përfituar pretendimin nga ky person me anë të zëvendësimit, kalimit ose ndonjë mënyre tjetër.

Neni 9

Moskrijimi i barrës detare

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet sikur krijon një barrë detare.

Neni 10

Rezervimi

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit apo aderimit, ose në çdo kohë pas tyre, mund të rezervojë të drejtën që të përjashtojë zbatimin e kësaj Konvente për ndonjë ose të gjitha sa më poshtë:

- a) anijet të cilat nuk janë duke lundruar në det;
 - b) anijet që nuk mbajnë flamurin e shtetit palë, pretendimet sipas nenit 1, paragrafi 1 (s).
2. Një shtet, kur është edhe shtet palë në një traktat të specifikuar për lundrimin në ujërat e brendshme, mund të deklarojë, kur nënshkruan, ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë, që rregullat për juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatës të parashikuara në këto traktate, do të kenë përparësi mbi rregullat që përmban neni 7 i kësaj Konvente.

Neni 11 **Depozituesi**

Kjo Konventë do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 12 **Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi**

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shteti në selinë e Kombeve të Bashkuar, Nju Jork nga 1 shtatori 1999 deri në 31 gusht 2000 dhe pas kësaj do të mbetet e hapur për aderim.
2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u detyruar nga kjo Konventë me anë:
- a) të nënshkrimit pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose
 - b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimin ose miratimit, të pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose
 - c) aderimi.
3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të hyjnë në fuqi me depozitimin e një instrumenti për këtë qëllim pranë depozitarit.

Neni 13 **Shtetet me më tepër se një sistem ligji**

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat aplikohen sisteme të ndryshme të ligjit në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë konventë, ai në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimin, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë që kjo konventë do të shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në njërën ose në disa prej tyre dhe mund ta modifikojë këtë deklaratë duke paraqitur një deklaratë tjetër në çdo kohë.
2. Çdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet depozituesit dhe do të deklarojë shprehimisht njësitë territoriale për të cilat aplikohet kjo Konventë.
3. Në lidhje me shtetin palë i cili ka dy ose më shumë sisteme të ligjit në lidhje me arrestin e anijeve që aplikohen në njësitë territoriale të ndryshme, referencat në këtë konventë për gjykatën e shtetit dhe ligjin e një shteti do të interpretohen përkatësisht se i referohen gjykatës së njësisë territoriale përkatëse brenda atij shteti dhe ligjit të njësisë territoriale përkatëse të atij shteti.

Neni 14 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën 10 shtete kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u detyruar prej saj.
2. Për një shtet që shpreh pëlqimin e tij për t'u detyruar nga kjo konventë pas plotësimit të kushteve për hyrjen në fuqi të saj, ky pëlqim do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së shprehjes së këtij pëlqimi.

Neni 15 **Rishikimi dhe amendimi**

1. Një konferencë e shteteve palë për qëllimin e rishikimit apo amendimit të kësaj Konvente do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara me kërkesën e një të tretës së

shteteve palë.

2. Çdo pëlqim për t'u detyruar nga kjo Konventë, i shprehur pas datës së hyrjes në fuqi të një amendamenti të kësaj Konvente, do të konsiderohet se aplikohet për konventën, siç amendohet.

Neni 16 **Denoncimi**

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga një shtet palë në çdo kohë pas datës në të cilën kjo konventë hyn në fuqi për atë shtet.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi me depozitimin e një instrumenti të denoncimit pranë depozitarit.

3. Një denoncim do të ketë fuqi një vit ose në një periudhë më të gjatë, siç mund të specifikohet në instrumentin e denoncimit pas marrjes së instrumentit të denoncimit nga depozitari.

Neni 17 **Gjuhët**

Kjo Konventë bëhet në një origjinal të vetëm në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku çdo tekst është njëloj autentik.

Bërë në Gjenevë, më dymbëdhjetë (12) mars, një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse për atë qëllim, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

LIGJ **Nr.10 036, datë 22.12.2008**

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEC-UT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE VENDORE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe vendore”, me një hua prej 15 (pesëmbëdhjetë) milionë USD.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5994, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

HUA Nr. 1215P

**PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE
(FAZA I)
MARRËVESHJE HUAJE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDIT TË OPEKUT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
DATË 4 NËNTOR 2008**

Marrëveshje e datës 4 nëntor, 2008, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe OFID-it.

Meqenëse Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga OFID për financimin e projektit të përshkruar në aneksin 1;

dhe meqë OFID ka miratuar një hua për Huamarrësin në një shumë prej pesëmbëdhjetë milionë dollarësh (\$ 15 000 000) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara më poshtë, prandaj, palët e kësaj Marrëveshje huaje (Marrëveshja) bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme këtu bashkëngjitur do të jenë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç fjalëve të përcaktuara në hyrje, fjalët dhe shprehjet në vijim do të kenë kuptimet e mëposhtme ose, kur ato përsërisin fjalët dhe kushtet në kushtet e përgjithshme, kuptimet specifike të mëposhtme:

- a) “Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit;
- b) “Data e mbylljes” është 31 dhjetor 2011;
- c) “Dollar dhe shenja \$” nënkupton dhe i referohet monedhës zyrtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- d) “Data e fillimit të shpenzimeve të pranueshme” është 18 qershor 2008;
- e) “Agjencia e zbatimit” është Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
- f) “Kushtet e përgjithshme” janë kushtet e përgjithshme të OFID-it, të aplikueshme në Marrëveshjet e huasë në sektorin publik, dhjetor 2007; dhe
- g) “Periudhë pa pagesë principali” është periudha që fillon më 4 nëntor 2008 dhe mbaron pesë (5) vjet nga ajo datë.

Neni 2

Huaja

2.01 OFID bie dakord t’i japë hua Huamarrësit dhe Huamarrësi bie dakord të marrë nga OFID-i huanë në një shumë prej pesëmbëdhjetë milionë dollarësh (\$ 15 000 000) në termat dhe kushtet e rëna dakord në këtë Marrëveshje.

2.02 Huamarrësi do të paguajë interes në një masë prej tre dhe dy të pestat e një përqindëshit (3.4%) në vit mbi shumën principale të huasë së tërhequr dhe të papaguar.

2.03 Huamarrësi do të paguajë një pagesë shërbimi në masën 1% në vit mbi shumën principale të huasë së tërhequr dhe të papaguar.

2.04 Interesi dhe pagesa e shërbimit do të paguhet çdo gjashtëmuor më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti në llogarinë e OFID-it.

2.05 Menjëherë pas përfundimit të periudhës pa pagesë principali, Huamarrësi do të paguajë principalin e huasë në dollarë, apo në çdo monedhë tjetër lehtësisht të konvertueshme të pranueshme nga drejtuesit e OFID-it, në një shumë të barasvlershme me shumën në dollarë, të caktuar sipas kursit

të këmbimit të tregut në vendin dhe kohën e shlyerjes. Shlyerja do të kryhet në tridhjetë (30) këste gjashtëmujore në shumat, dhe në datat siç janë përcaktuar në aneksin 3 (Amortizimi).

Neni 3 Efektiviteti

3.01 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekte në përputhje me seksionin 3.02 pas marrjes nga OFID-i të:

a) treguesve të kënaqshëm se zbatimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar dhe ratifikuar sipas kërkesave kushtetuese të Huamarrësit;

b) një vërtetim lëshuar nga Ministri i Drejtësisë apo përfaqësuesi ligjor i përgjithshëm, apo çdo autoritet ligjor tjetër kompetent i Huamarrësit që vërteton se kjo Marrëveshje është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin në përputhje me termat e saj;

c) treguesve se marrëveshja e huasë ndërmjet Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Huamarrësit është deklaruar efektive apo do të deklarohet efektive njëkohësisht me këtë Marrëveshje; dhe

d) treguesve të kënaqshëm se të ardhurat e huasë kanë qenë apo do të vihen në dispozicion të agjencisë së zbatimit.

3.02 Pasi kushtet e specifikuar në seksionin 3.01 do të jenë përmbushur në mënyrë të kënaqshme, drejtuesit e OFID-it do të bëjnë që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi dhe të ketë efekt në datën e efektivitetit siç do t'i njoftohet Huamarrësit.

3.03 Nëse kjo Marrëveshje nuk do të bëhet efektive brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas datës së Marrëveshjes, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë, përveç kur drejtuesit e OFID-it, pasi të marrin parasysh arsyet për vonesë, do të caktojnë një datë të mëvonshme për qëllimin e këtij seksioni.

Neni 4 Adresat

4.01 Adresat e palëve janë siç specifikohen më poshtë:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bul. "Dëshmorët e Kombit", nr.4,
Tiranë

Republika e Shqipërisë

Faks: (++ 335-4) 229200

Për OFID:

Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar

Parkring 8

A-1010 Vienna

Austria

Faks: (++ 43-1) 513 92 38

HUA Nr. 1215 P

Në dëshmi të kësaj, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet dhe të dërgohet në Vjenë në dy kopje në gjuhën angleze, secili i konsideruar një origjinal dhe të dy me të njëjtin efekt si në ditën dhe vitin e shënuar në fillim më sipër.

PËR HUAMARRËSIN:

Nënshkrimi:

Emri:

Ridvan Bode

Titulli:

Ministër i Financave

PËR FONDIN E OPEKUT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR:

Nënshkrimi:

Emri:

z.Sulejman J.Al-Herbish

Titulli:

Drejtör i Përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE
(FAZA I)

ANEKSI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti është rehabilitimi dhe rindërtimi i rrjetit dytësor dhe lokal të rrugëve në Shqipëri, në mënyrë që të përmirësojë përqasjen e popullsisë vendase në brendësi të vendit ndaj shërbimeve kryesore dhe tregjeve ekonomike. Objektivat e projektit do të arrihen nëpërmjet zbatimit të komponentëve të mëposhtëm:

a) Punime civile - rrugë dytësore : përfshin financimin e punimeve civile që kanë të bëjnë me rindërtimin dhe rehabilitimin e seksioneve prioritare të përzgjedhura të rrjetit të rrugëve dytësore (rajonale), të përmendura më poshtë, te standardet e asfaltit. Këtu përfshihet edhe instalimi i infrastrukturës së sigurisë rrugore.

Rajoni	Seksioni i rrugës	Gjatësia (km)
i) Vlorë	Xarrë – fshati Pllakë	9.1
ii) Tiranë	Ura e Farkës/ura e Erzenit – Qendër fshat	6.5
iii) Korçë	Kryqëzim Lapidar – Koritë	8

b) Punime civile - rrugë lokale: përfshin financimin e punimeve civile që kanë të bëjnë me rindërtimin dhe rehabilitimin e seksioneve prioritare të përzgjedhura të rrjetit të rrugëve lokale, të përmendura më poshtë, te standardet e asfaltit. Këtu përfshihet edhe instalimi i infrastrukturës së sigurisë rrugore.

Rajoni	Seksioni i rrugës	Gjatësia (km)
i) Dibër	Kuben – përroi i Kapsit	10
ii) Lezhë	Lezhë - Kallmet	11
iii) Kukës	Domaj – ura e Lapajve	10
iv) Shkodër	Vau i Dejës – Nenshat	11,6
v) Fier	Strumë – qafa e Marinzës	11,5
vi) Elbasan	Belsh – Fierzë	9
vii) Berat	Ura e Goricës – fshat Mbreshtan	8
viii) Gjirokastrë	Valare - Erind	6,5

c) Menaxhimi i projektit dhe mbështetja institucionale: Ky komponent do të financojë: i) prokurimin e shërbimeve për një firmë konsulence ndërkombëtare për të mbikëqyrur punimet civile; ii) një asistent teknik; iii) koston e vizitave në terren dhe trajnimet e nevojshme të stafit të agjencisë zbatuese; iv) punët përgatitore të njësisë përgatitore të projektit (NPP); v) automjetet e nevojshme, pajisje zyre dhe mobilie, pajisje kompjuterike, programe kompjuterike të gatshme dhe pajisje gjeneratori për energji elektrike; vi) kostot operacionale të agjencisë zbatuese dhe grupeve të zbatimit të projektit, duke përfshirë pagat, kontributet shoqërore dhe shpenzime karburanti; vii) konsulentë individualë të ndryshëm që do të asistojnë agjencinë e zbatimit në zbatimin e projektit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE (FAZA I)

ANEKSI 2
SHPËRNDARJA E HUASË

1. Përveç kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe drejtuesve të OFID-it, tabela e mëposhtme përcakton komponentët që do të financohen nga të ardhurat e huasë, shpërndarjen e shumave të huasë në çdo komponent dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që do të financohen në lidhje me çdo komponent:

Komponenti	Shuma e huasë e caktuar	Përqindja e shpenzimeve totale
------------	----------------------------	-----------------------------------

	(Shprehur në US dollar)	për t'u financuar
a) Punë civile – rrugë dytësore	5 000 000	58.9
b) Punë civile – rrugë lokale	10 000 000	58.8
c) Menaxhimi i projektit dhe mbështetja institucionale	-	-
Totali:	15 000 000	

2. Pavarësisht nga shpërndarja e një shume të huasë apo përqindjet e disbursimit, të përcaktuara në tabelën në paragrafin 1 më sipër, nëse drejtuesit e OFID-it kanë çmuar në mënyrë të arsyeshme se shuma e huasë e alokuar për secilin nga komponentët do të jetë e pamjaftueshme të financojë përqindjen e miratuar të të gjitha shpenzimeve në atë komponent, drejtuesit e OFID-it mundin, duke njoftuar Huamarrësin: i) të rialokojnë për një komponent të tillë, në masën e kërkuar për të plotësuar mungesën e vlerësuar, të ardhurat e huasë të cilat janë të alokuara për një tjetër komponent dhe të cilat sipas mendimit të drejtuesve të OFID-it nuk nevojiten për shpenzime të tjera; dhe ii) nëse një rialokim i tillë nuk mundet të plotësojë mungesën e vlerësuar, të ulin përqindjen e disbursimit të aplikueshëm për këto shpenzime në mënyrë që tërheqjet e mëtejshme, në lidhje me këtë komponent, mund të vazhdojnë derisa të gjitha shpenzimet nën të të jenë kryer.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE (FAZA I)

ANEKSI 3
AMORTIZIMI

Nr.	Data e shlyerjes	Shuma për t'u paguar (shprehur në US dollarë)
1	15 nëntor 2013	500,000
2	15 maj 2014	500,000
3	15 nëntor 2014	500,000
4	15 maj 2015	500,000
5	15 nëntor 2015	500,000
6	15 maj 2016	500,000
7	15 nëntor 2016	500,000
8	15 maj 2017	500,000
9	15 nëntor 2017	500,000
10	15 maj 2018	500,000
11	15 nëntor 2018	500,000
12	15 maj 2019	500,000
13	15 nëntor 2019	500,000
14	15 maj 2020	500,000
15	15 nëntor 2020	500,000
16	15 maj 2021	500,000
17	15 nëntor 2021	500,000
18	15 maj 2022	500,000
19	15 nëntor 2022	500,000
20	15 maj 2023	500,000
21	15 nëntor 2023	500,000
22	15 maj 2024	500,000
23	15 nëntor 2024	500,000
24	15 maj 2025	500,000

25	15 nëntor 2025	500,000
26	15 maj 2026	500,000
27	15 nëntor 2026	500,000
28	15 maj 2027	500,000
29	15 nëntor 2027	500,000
30	15 maj 2028	500,000
Totali:		15,000,000

LIGJ
Nr.10 037, datë 22.12.2008

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
E KOMBEVE EUROPIANE “PËR BASHKËPROD HIMET KINEMATOGRAFIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika Shqipërisë aderon në konventën europiane “Për bashkëprodhimet kinematografike”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5995, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA EUROPIANE MBI BASHKËPROD HIMET KINEMATOGRAFIKE
Strasburg, 2.10.1992

Parathënie

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera palë në Konventën Kulturore Europiane, nënshkruese këtu,

dukë marrë parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është që të arrijë një bashkim më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me qëllimin, në veçanti, për të ruajtur dhe nxitur idealet dhe parimet që

formojnë trashëgiminë e përbashkët;

duke marrë parasysh se liria e krijimtarisë dhe liria e shprehjes përbëjnë elemente themelore të këtyre parimeve;

duke marrë parasysh se mbrojtja e larmisë kulturore të vendeve të ndryshme europiane është një nga qëllimet e Konventës Kulturore Europiane;

duke marrë parasysh se bashkëprodhimi kinematografik, si mjet i krijimtarisë dhe shprehjes së larmisë kulturore në shkallë europiane duhet të forcohet më tej;

të vendosur për t'i zhvilluar këto parime dhe duke sjellë ndërmend rekomandimet e Komitetit të Ministrave në fushën e kinemasë dhe atë audiovizuale, dhe veçanërisht rekomandimin nr.R (86) 3 mbi nxitjen e prodhimit audiovizual në Europë;

duke njohur se krijimi i Fondit European për Mbështetjen e Bashkëprodhimit dhe Shpërndarjes së Punimeve Krijuese Kinematografike dhe Audiovizuale, Eurimages, i përgjigjet shqetësimit në nxitje të bashkëprodhimeve kinematografike europiane dhe se një forcë e re udhëheqëse i është dhënë në këtë mënyrë zhvillimit të bashkëprodhimeve kinematografike në Europë;

të vendosur për të arritur këtë synim kulturor falë një përpjekje të përbashkët për të rritur prodhimin dhe për të përcaktuar rregullat, të cilat u përshtaten bashkëprodhimeve kinematografike kulturore europiane të shumëpalëshe si një e tërë;

duke pasur parasysh se adoptimi i rregullave të përbashkëta prirët të pakësojë kufizimet dhe t'i japë shtysë bashkëpunimit europian në fushën e bashkëprodhimit kinematografik, kanë rënë dakord si vijon.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Qëllimi i Konventës**

Palët në këtë Konventë marrin përsipër që të nxisin zhvillimin e bashkëprodhimit kinematografik europian në përputhje me dispozitat që vijnë.

Neni 2 **Fusha e veprimit**

1. Kjo Konventë do të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet Palëve në fushën e bashkëprodhimeve shumëpalëshe në territorin e Palëve.

2. Kjo Konventë do të zbatohet për:

a) Bashkëprodhimet që përfshijnë të paktën tre bashkëprodhues, të vendosur në tre vende të ndryshme Palë të kësaj Konvente; dhe

b) Bashkëprodhimet që përfshijnë të paktën tre bashkëprodhues të vendosur në tre vende të ndryshme Palë të kësaj Konvente dhe një apo më shumë bashkëprodhues, të cilët nuk janë të vendosur në këto vende Palë. Kontributi i përgjithshëm i bashkëprodhuesve të cilët nuk janë të vendosur në vendet Palë të kësaj Konvente, sidoqoftë, nuk duhet të kalojë 30% të kostos së përgjithshme të prodhimit.

Në të gjitha rastet, kjo Konventë do të zbatohet vetëm me kushtin që vepra e bashkëprodhuar të përputhet me përkufizimin e veprës kinematografike europiane siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 3, më poshtë.

3. Dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe të arritura ndërmjet Palëve të kësaj Konvente do të vazhdojnë të zbatohen për bashkëprodhimet dypalëshe. Në rastin e bashkëprodhimeve shumëpalëshe, dispozitat e kësaj Konvente do të mbizotërojnë mbi ato të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve Palë në këtë Konventë. Dispozitat në lidhje me bashkëprodhimet dypalëshe do të mbeten në fuqi, në rast se ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente.

4. Në rast se nuk ka asnjë marrëveshje që rregullon marrëdhëniet e bashkëprodhimit dypalësh

ndërmjet Palëve të kësaj Konvente, Konventa do të zbatohet gjithashtu ndaj bashkëprodhimeve dypalëshe, përveçse kur është bërë një rezervim nga njëra nga Palët e përfshira sipas kushteve të nenit 20.

Neni 3 **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) termi "vepër kinematografike" do të nënkuptojë një vepër të çfarëdo gjatësie apo mjeti, në veçanti veprat kinematografike krijuese, ato me kartonë dhe dokumentarët, të cilat janë në përputhje me dispozitat që rregullojnë industrinë e filmit që janë në fuqi në secilin nga Palët e interesuara dhe që ka për qëllim të shfaqet në kinema;

b) termi "bashkëprodhues" do të nënkuptojë shoqëritë e prodhimit kinematografik apo prodhuesit e vendosur në vendet Palë të kësaj Konvente të përfshira në një kontratë bashkëprodhimi;

c) termi "vepër kinematografike europiane" do të nënkuptojë një vepër kinematografike që është në përputhje me kushtet e përcaktuara në shtojcën II, e cila është pjesë e kësaj Konvente;

d) termi "bashkëprodhim shumëpalësh" do të nënkuptojë një vepër kinematografike të prodhuar të paktën nga tre bashkëprodhues, siç përcaktohet në nenin 2 paragrafi 2, më lart.

KREU II **RREGULLAT E ZBATUESHME PËR BASHKËPRODHIMET**

Neni 4 **Përfshirja në filmat vendas**

1. Veprat kinematografike europiane, të prodhuara si bashkëprodhime shumëpalëshe dhe që janë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, do të gëzojnë përfitimet që u jepen filmave vendas nga dispozitat legjislative dhe rregulluese në fuqi në secilën nga Palët e kësaj Konvente, që marrin pjesë në bashkëprodhimin në fjalë.

2. Përfitimet do të jepen për secilin bashkëprodhues nga Pala në vendin e të cilit është vendosur bashkëprodhuesi, sipas kushteve dhe kufizimeve të vëna nga dispozitat legjislative dhe rregulluese në fuqi në atë Palë dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 5 **Kushtet për të përfituar statusin e bashkëprodhimit**

1. Çfarëdo bashkëprodhim i veprave kinematografike do t'i nënshtrohet miratimit të autoriteteve kompetente të Palëve, në vendet e të cilave janë vendosur bashkëprodhuesit, pas këshillimit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në shtojcën I. Kjo shtojcë do të përbëjë pjesë të njësishe të kësaj Konvente.

2. Kërkesat për statusin e bashkëprodhimit do të paraqiten për miratim përpara autoriteteve kompetente, në përputhje me procedurën e aplikimit të përcaktuar në shtojcën I. Ky miratim do të jetë përfundimtar, përveçse në rastin kur nuk arrihet të përmbushen sipërmarrjet fillestare në lidhje me çështjet artistike, financiare dhe teknike.

3. Projekteve të një natyre të qartë pornografike ose atyre që mbrojnë dhunën apo fyejnë haptazi dinjitetin njerëzor nuk mund t'u jepet statusi i bashkëprodhimit.

4. Përfitimet e siguruara nga statusi i bashkëprodhimit do t'u jepen bashkëprodhuesve të cilët vlerësohen se kanë mjetet e përshtatshme teknike e financiare dhe kualifikimet e mjaftueshme profesionale.

5. Secili Shtet Kontraktues do të përcaktojë autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 2 më lart me anë të një deklarate të bërë në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton aktin e vet të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes. Kjo deklaratë mund të ndryshohet në cilëndo datë të mëvonshme.

Neni 6

Pjesët e kontributeve nga secili bashkëprodhues

1. Në rastin e bashkëprodhimit shumëpalësh, kontributi minimal duhet të jetë jo më pak se sa 10% dhe kontributi maksimal nuk duhet të kalojë 70% të kostos së përgjithshme të prodhimit të veprës kinematografike. Kur kontributi minimal është më pak se sa 20%, Pala e interesuar mund të ndërmarrë hapa për të pakësuar apo penguar hyrjen te skemat e mbështetjes së prodhimit vendas.

2. Kur kjo Konventë merr rolin e një marrëveshje dypalëshe ndërmjet dy vendeve, sipas dispozitave të nenit 2 paragrafi 4, kontributi minimal nuk duhet të jetë më pak se sa 20% dhe kontributi më i madh nuk duhet të tejkalojë 80% të kostos së përgjithshme të veprës kinematografike.

Neni 7

Të drejtat e bashkëprodhuesve

1. Kontrata e bashkëprodhimit duhet të garantojë për secilin bashkëprodhues pronësinë e përbashkët të negativit të pamjes dhe zërit origjinal. Kontrata do të përfshijë dispozitën që ky negativ të mbahet në një vend të rënë dakord bashkërisht nga bashkëprodhuesit, si dhe t'u garantojë atyre hyrje të lirë në të.

2. Kontrata e bashkëprodhimit duhet të garantojë gjithashtu të drejtën për një negativ të ndërmjetëm apo për çfarëdo mjet tjetër riprodhimi.

Neni 8

Pjesëmarrja teknike dhe artistike

1. Kontributi i secilit nga bashkëprodhuesit do të përfshijë pjesëmarrjen efektive teknike dhe artistike. Në parim dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, të cilave u nënshtrohen Palët, kontributi i bashkëprodhuesve në lidhje me personelin krijues, teknik e artistik, aktorët dhe mjediset duhet të jenë në përpjesëtim me investimin e tyre.

2. Sipas detyrimeve ndërkombëtare, të cilave u nënshtrohen Palët dhe sipas kërkesave të skenarit, ekipi teknik dhe mbështetës i përfshirë në filmimin e veprës, duhet të përbëhet nga shtetas të shteteve të cilat janë partnerë në bashkëprodhim dhe faza e pas-prodhimit do të zhvillohet normalisht në ato shtete.

Neni 9

Bashkëprodhimet financiare

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 8 dhe duke iu nënshtuar kushteve dhe kufizimeve të hollësishme të përcaktuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi në çdo Palë, bashkëprodhimeve mund t'u jepet statusi i bashkëprodhimit sipas dispozitave të kësaj Konvente, në rast se ato plotësojnë kushtet në vijim:

a) Përfshijnë një apo më shumë kontribute të vogla të cilat mund të jenë vetëm financiare, në përputhje me kontratën e bashkëprodhimit, me kusht që çdo pjesë nga secili vend të mos jetë më pak se 10% e as më shumë se 25% e kostove të prodhimit;

b) Përfshijnë një bashkëprodhues kryesor i cili jep një kontribut efektiv teknik dhe artistik dhe përmbush kushtet për veprën kinematografike që të njihet si vepër kombëtare në vendin e tij;

c) Ndihmojnë që të nxitet identiteti evropian; dhe

d) Mishërohen në kontrata bashkëprodhimi të cilat përfshijnë dispozita për shpërndarjen e faturave.

2. Bashkëprodhimet financiare do të kualifikohen për statusin e bashkëprodhimit, pasi autoritetet kompetente të kenë dhënë miratimin e tyre në secilin rast individualisht, veçanërisht duke mbajtur parasysh dispozitat e nenit 10 më poshtë.

Neni 10

Ekulibri i përgjithshëm

1. Një ekuilibër i përgjithshëm duhet ruajtur në marrëdhëniet kinematografike të Palëve, si në lidhje me shumën e përgjithshme të investuar ashtu edhe në lidhje me pjesëmarrjen teknike dhe

artistike në veprat kinematografike të bashkëprodhuara.

2. Një Palë, e cila për një periudhë të arsyeshme kohe, ka deficit në marrëdhëniet e saj të bashkëprodhimit kundrejt një apo më shumë Palëve të tjera, me qëllim ruajtjen e identitetit të vet kulturor, mund të mos japë miratimin e saj për një bashkëprodhim vijues derisa të rivendosën marrëdhënie të ekuilibruara kinematografike në lidhje me atë apo ato Palë.

Neni 11

Hyrja dhe qëndrimi

Në përputhje me ligjet dhe rregulloret, si edhe me detyrimet ndërkombëtare në fuqi, secila, palë do të lehtësojë hyrjen dhe qëndrimin, si edhe dhënien e lejeve të punës në territorin e saj, për personelin teknik dhe artistik nga Palët e tjera që marrin pjesë në një bashkëprodhim. Në mënyrë të ngjashme, secila Palë do të lejojë importimin e përkohshëm dhe rieksporimin e pajisjeve të nevojshme për prodhimin dhe shpërndarjen e veprave kinematografike që janë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente.

Neni 12

Atributet e vendeve bashkëprodhuese

1. Vendeve bashkëprodhuese do t'u jepen attribute në veprat e bashkëprodhuara kinematografike.

2. Emrat e këtyre vendeve do të përmenden qartësisht në titujt e attributeve në të gjitha materialet e publicitetit dhe reklamës, si edhe kur shfaqen veprat kinematografike.

Neni 13

Eksporti

Kur një vepër kinematografike eksportohet në drejtim të një vendi ku importi i veprave kinematografike u nënshtrohet kuotave dhe njëra nga Palët bashkëprodhuese nuk gëzon të drejtën e futjes së lirë të veprave të saj kinematografike për në vendin importues:

a) Vepra kinematografike do t'i shtohet normalisht kuotës së vendit i cili ka pjesëmarrjen më të madhe;

b) Në rastin e një vepre kinematografike që përfshin një pjesëmarrje të barabartë nga vende të ndryshme, vepra kinematografike do t'i shtohet kuotës së vendit i cili ka mundësitë më të mira për të eksportuar në drejtim të vendit importues;

c) Kur dispozitat e nënparagrafëve "a" dhe "b" më lart nuk mund të zbatohen, vepra kinematografike do të futet në kuotën e Palës, e cila dërgon drejtuesin e saj.

Neni 14

Gjuhët

Kur është në përputhje me statusin e bashkëprodhimit, autoriteti kompetent i një Pale mund të kërkojë nga bashkëprodhuesi i përcaktuar atje një variant përfundimtar të veprës kinematografike në një nga gjuhët e asaj Pale.

Neni 15

Festivalet

Përveçse kur bashkëprodhuesit vendosin ndryshe, veprat kinematografike të bashkëprodhuara do të shfaqen në festivalet ndërkombëtare nga Pala ku është vendosur bashkëprodhuesi kryesor ose, në rast të pjesëmarrjes së barabartë financiare, nga Pala e cila dërgon drejtuesin e veprës.

KREU III
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe nga shtetet të tjera palë në Konventën Kulturore Europiane, të cilat mund të shprehin pëlqimin e tyre që ta bëjnë atë të detyrueshme për to me anë të:

- a) Nënshkrimit pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin apo miratimin; ose
- b) Nënshkrimit duke iu nënshtruar ratifikimit ose miratimit, të ndjekur më pas nga ratifikimi, pranimi apo miratimi.

2. Aktet e ratifikimit, pranimin apo miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të një periudhe prej tre muajsh, pas datës në të cilën pesë shtete, duke përfshirë të paktën katër shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre që t'i nënshtrohen Konventës në përputhje me dispozitat e nenit 16.

2. Në lidhje me cilindo shtet nënshkrues, i cili në vijim shpreh pëlqimin e tij që t'i nënshtrohet asaj, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të një periudhe prej tre muajsh, pas datës së nënshkrimit apo të depozitimit të aktit të ratifikimit, pranimin apo miratimit.

Neni 18

Hyrja e shteteve joanëtare

1. Pas hyrjes së fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë cilindo shtet europian që nuk është anëtar i Këshillit të Europës, si edhe Komunitetin Ekonomik Europian që të bëhet anëtar i kësaj Konvente, me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të statusit të Këshillit të Europës dhe me votën e njëzëshme të përfaqësuesve të Shteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë pjesë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet që është duke u anëtarësuar apo që është anëtar i Komunitetit Ekonomik Europian, në rastin e hyrjes së tij, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të një periudhe prej tre muajsh, pas datës së depozitimit të aktit të hyrjes pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 19

Dispozita territoriale

1. Cilindo shtet mundet që, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton aktin e tij të ratifikimit, pranimin, miratimit apo hyrjes, të përcaktojë me hollësi territorin apo territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Cilado Palë mundet që, në një datë të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në cilindo territor tjetër të përcaktuar me hollësi në këtë deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të një periudhe prej tre muajsh nga data e marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çfarëdo deklarate e bërë sipas dy paragrafëve paraardhës, mundet që, në lidhje me cilindo territor të përcaktuar me hollësi në një deklaratë të tillë, të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të një periudhe prej tre muajsh, pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 20 **Rezervime**

1. Cilido shtet mundet që, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton aktin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit apo hyrjes, të deklarojë se neni 2 paragrafi 4, nuk zbatohet për marrëdhëniet e tij dypalëshe të bashkëprodhimit me një apo më shumë Palë. Për më tepër, ai mund të rezervojë të drejtën për të caktuar një pjesëmarrje maksimale, të ndryshme nga ajo që përcaktohet në nenin 9, paragrafi 1.a. Asnjë rezervim tjetër nuk mund të bëhet.

2. Cilado Palë që ka bërë një rezervim, sipas paragrafit paraardhës mund ta tërheqë atë pjesërisht apo tërësisht me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 21 **Denoncimi**

1. Cilado Palë mundet që, në çdo kohë, ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të një periudhe prej gjashtë muajsh, pas datës së marrjes të njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 22 **Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i njoftojë shtetet anëtare të Këshillit, si edhe cilindo shtet dhe Komunitetin Ekonomik Europian, të cilët mund të bëhen pjesë e kësaj Konvente apo mund të ftohen që të bëhen pjesë, për:

- a) Çdo nënshkrim;
- b) Depozitimim e cilitdo akt ratifikimi, pranimi, miratimi apo hyrje;
- c) Cilëndo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenet 17, 18 dhe 19;
- d) Çdo deklaratë të bërë, në përputhje me nenin 5 paragrafi 5;
- e) Çdo denoncim të njoftuar, në përputhje me nenin 21;
- f) Çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim, në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, në ditën e dytë të tetorit 1992, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dy tekstet janë njëllor të barasvlershme, në një kopje të vetme e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm do t'u përcjellë shteteve të përmendura në nenin 16 paragrafi 1, kopje të vërtetuara ashtu si edhe cilitdo shtet dhe Komunitetit Ekonomik Europian, i cili mund të ftohet të bëhet pjesë e kësaj Konvente.

Me qëllim që të përfitojnë nga dispozitat e kësaj Konvente, bashkëprodhuesit e vendosur në vendet Palë duhet që, dy muaj përpara fillimit të xhirimeve, të paraqesin një aplikim për statusin e bashkëprodhimit dhe t'i bashkëngjisin atij dokumentet e rreshtuara më poshtë. Këto dokumente duhet të mbërrijnë tek autoritetet kompetente në një numër të mjaftueshëm kopjesh që të mund t'u shpërndahen edhe autoriteteve të Palëve të tjera të paktën një muaj përpara fillimit të xhirimeve:

- kopje e kontratës për blerjen e së drejtës së autorit apo çfarëdo provë tjetër e blerjes të së drejtës së autorit për shfrytëzimin tregtar të veprës;
- një skenar të hollësishëm;
- një listë të kontributeve teknike dhe artistike prej secilit nga vendet e përfshira;
- një preventiv dhe një plan të hollësishëm financiar;
- një program për prodhimin e veprës kinematografike;
- kontratën e bashkëprodhimit të arritur ndërmjet bashkëprodhuesve. Kjo kontratë duhet të përfshijë dispozita mbi shpërndarjen e faturave dhe territoreve ndërmjet bashkëprodhuesve.

Aplikimi dhe dokumentet e tjera do të paraqiten, nëse është e mundur, në gjuhën e autoriteteve kompetente të cilave ato u paraqiten.

Autoritetet kompetente vendase do t'i dërgojnë njëra – tjetrës aplikimin dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, pasi t'i kenë marrë ato. Autoriteti kompetent i Palës me pjesëmarrjen financiare më të vogël nuk do të japë miratimin e tij derisa të jepet mendimi i Palës me pjesëmarrjen financiare më të madhe.

SHTOJCA II

1. Një vepër kinematografike cilësohet si europiane në kuptim të nenit 3 paragrafi 3, nëse ajo arrin të paktën 15 pikë nga një total prej 19, në përputhje me programin e elementeve europiane të përcaktuara më poshtë.

2. Duke mbajtur parasysh kërkesat e skenarit, autoritetet kompetente, pas këshillimit së bashku dhe nëse ato quajnë se vepra pasqyron sidoqoftë një identitet europian, mund të japin statusin e bashkëprodhimit ndaj një vepre me më pak sesa numri i kërkuar normalisht i pikëve që është 15.

Elementet europiane	Pikët
Grupi krijues	
Regjisor	3
Skenari	3
Kompozitori	1
	—
	7
Grupi i aktorëve	
Roli parësor	3
Roli dytësor	2
Roli i tretë	1
	—
	6
Grupi i ekipit teknik	
Kameramani	1
Operatori i zërit	1

Botuesi	1
Drejtuesi artistik	1
Vendndodhja e studios ose e xhirimeve	1
Vendndodhja në fazën e pas-prodhimit	1
	—
	6

Shënim.

a) Roli parësor, dytësor dhe i tretë përcaktohen nga ditët e punës të zhvilluara.

b) Përsa i përket nenit 8, fjala “artistike” u referohet grupeve krijuese dhe atyre të aktorëve, ndërsa “teknike” i referohet grupit të ekipit teknik.

Raport shpjegues

Bashkëpunimi kulturor evropian në fushën e kinemasë ndodh para së gjithash përmes bashkëprodhimeve. Në këto përpjekje të përbashkëta për të mbështetur krijimtarinë (për një kohë të gjatë dypalëshe, por gjithnjë e më shumë shumëpalëshe), rregullat për mbështetjen e shtetit ndaj prodhimit të filmave nuk janë gjithmonë të njëjtat. Synimet kryesore për këtë Konventë janë që të minimizohen ndryshimet dhe të harmonizohen marrëdhëniet shumëpalëshe ndërmjet shteteve kur ato vendosin të prodhojnë një film.

E hartuar për të nxitur zhvillimin e bashkëprodhimit të filmave në Europë, Konventa përpiqet që të thjeshtojë procedurat dhe prodhimin mbi bazën e kriterëve të vendosura nga fondi Eurimages (një fond evropian i krijuar në kuadrin e Këshillit të Europës në vitin 1988 me qëllim që të mbështesë bashkëprodhimet dhe shpërndarjen e filmave dhe prodhimeve audiovizuale). Ajo përbën gjithashtu një hap përpara në uljen e pengesave për pjesëmarrjen financiare në bashkëprodhime dhe gjithashtu në lejin e bashkëprodhimeve financiare me kusht që këto të nxisin identitetin Evropian. Kjo kërkesë në lidhje me identitetin është në shumë drejtime parimi udhëheqës i Konventës, çka frymëzohet nga një pamje e gjithanshme, por e njëjtësuar e prodhimit të filmit evropian.

Hyrje

Prodhimi kinematografik në Europë është një veprimtari që kryhet në thelb në nivele kombëtare. Ndryshimet gjuhësore dhe kulturore kanë sjellë si pasojë që çdo vend të krijojë kinemanë e tij, secila me tiparet e saj të ravijëzuara qartësisht. Traditat e larmishme që tipizojnë për shembull kinemanë italiane, britanike apo franceze, janë dukshëm të identifikueshme.

Kjo gjendje ka çuar drejt konceptimit të filmave të drejtuar kryesisht e mbi të gjitha drejt tregjeve të brendshme vendase. Sigurisht, cilësia dhe vlera e disa prodhimeve ka bërë që ato të përhapen edhe më gjerë. Neorealizmi, komeditë e famshme italiane, rryma “Nouvelle Vague” dhe kinemaja e lirë britanike, sa për të cituar disa shembuj, janë brohoritur shumë përtej kufijve të vendeve të tyre të origjinës. Sidoqoftë, ato janë prodhuar me financime që kanë mbajtur parasysh para së gjithash tregjet e brendshme vendase.

Zhvillimi i televizionit shkaktoi një rënie të ndjekjes së kinemasë gjatë viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë. Burimi i natyrshëm i financimit të filmave – nga biletat e atyre që ndiqnin kinemanë, u bë gjithnjë e më pak i rëndësishëm. Një rritje e konsiderueshme në kostot e prodhimit shtoi edhe më shumë vështirësitë në këtë fushë. Duke qenë se tregjet e brendshme vendase nuk ishin më të mjaftueshme për të financuar prodhime – ndryshe nga tregu i brendshëm në Shtetet e Bashkuara, të cilat kanë një popullsi prej 250 milionë banorësh, shumica dërrmuese e të cilëve flasin të njëjtën gjuhë – prodhuesit evropianë të filmit iu drejtuan bashkëprodhimeve. Këto kërkojnë një marrëveshje paraprake ndërmjet shteteve që secili prej tyre t’i njohë shtetësinë e vet filmave të prodhuar nga të dy vendet. Në këtë mënyrë, një prodhim mund të gëzojë nga përfitimet që u jepen veprave kombëtare vendase dhe të tërheqë financime publike apo private në të dy vendet. Marrëveshja e parë e këtij lloji, e cila vendosi edhe kuadrin përkatës, u nënshkrua ndërmjet Italisë dhe Francës. Që atëherë, një numër i madh marrëveshjesh janë hartuar ndërmjet vendeve evropiane prodhuese të filmave.

Në formën e vet klasike, bashkëprodhimi ka ndihmuar pa dyshim kinemanë evropiane që të mbijetojë. Gjithsesi, ai ka kufizimet e veta dhe mund të çojë drejt pasojave të padëshiruara. Duke qenë se ai kërkon pjesëmarrjen teknike dhe artistike krahas financimeve, ai ka çuar në krijimin e veprave të bëra artificialisht në të cilat aktorët dhe teknikët zgjidhen shpesh më shumë për shkak të shtetësisë së

tyre, sesa për arsye që lidhen me mbarëvajtjen e filmit.

Ndërsa kanë qenë të përshtatshme për marrëdhëniet dypalëshe, marrëveshjet e bashkëprodhimit janë përdorur gjithashtu për të krijuar bashkëprodhimeve që përfshijnë më shumë se dy vende. Në fakt, shumica e marrëveshjeve të tilla e ofrojnë në mënyrë të shprehur këtë mundësi. Sidoqoftë, marrëveshjet dypalëshe nuk janë të standardizuara dhe lënë hapësirë për paqartësi, me rrezikun që njërit nga bashkëprodhuesit mund t'i ofrohen kushte më pak të favorshme sesa të tjerëve.

Me krijimin e fondit të mbështetjes së Këshillit të Europës, Eurimages, u bë urgjente nevoja për harmonizim. Me qëllimin për të mbështetur veprat kinematografike të bashkëprodhuara nga ortakë të vendosur në të paktën tre vende, fondi Eurimages ka çuar drejt një rritje thelbësore në bashkëprodhimin shumëpalësh, ndërsa ka vendosur kushte të ndryshme nga ato që përmbahen në marrëveshjet e bashkëprodhimit. Për shembull, Eurimages kërkon një financim prej vetëm 10% nga një nga ortakët, ndërsa shumica e marrëveshjeve të bashkëprodhimit kërkojnë një pjesëmarrje prej 20% apo edhe 30%.

Është bërë kështu e nevojshme që të miratohen rregulla që t'i përshtaten të gjithë gamës së bashkëprodhimeve shumëpalëshe europiane pa vënë sigurisht në dyshim marrëdhëniet ekzistuese dypalëshe. Një konventë duket se është forma më e përshtatshme e mjetit ligjor për këtë qëllim.

Në fakt, një konventë europiane ka përparësinë që të sigurojë një bazë ligjore që rregullon marrëdhëniet kinematografike të të gjitha shteteve palë në këtë Konventë. Në përcaktimin e kushteve për përfitim të statusit të bashkëprodhimit të zbatueshëm për të gjitha Shtetet Palë, një konventë e tillë europiane heq pengesat që do të rridhnin nga ekzistenca e shumë marrëveshjeve të ndryshme shumëpalëshe ndërqeveritare që duhet të mbaheshin parasysh, pengesa të cilat rrjedhin si nga pabarazia ndërmjet përcaktimeve të vendosura në këto marrëveshje, ashtu edhe nga kompleksiteti i marrëdhënieve ligjore të cilat do të siguronin, veçanërisht në lidhje me Shtetet Palë ndaj shumë marrëveshjeve dypalëshe, që të vendoseshin kushte të ndryshme bashkëprodhimi. Një instrument i vetëm kontraktor përbën një mjet të rëndësishëm për zhvillimin dhe nxitjen e bashkëprodhimeve në Europë dhe thjeshton marrëdhëniet kinematografike ndërmjet shteteve prodhuese. Në lidhje me këtë, duhet të vihet re se Konventa Europiane mbi Bashkëprodhimet Kinematografike ka një fushë të gjerë gjeografike shtrirje e zbatimi, duke qenë se ajo është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera të cilat janë anëtare të Këshillit të Europës, si edhe shtetet e tjera që janë Palë në Konventën Kulturore Europiane, si edhe për hyrjen e shteteve europiane joanëtare.

Për më tepër, mundësia e bashkimit me vende të tilla si Kanadaja, të cilat kanë statusin e vëzhguesit në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, e që kanë arritur marrëveshje të shumta kinematografike me vende europiane, me të cilat ato kanë lidhje të ngushta kulturore, është duke u shqyrtuar.

Një numër shtetesh europiane nuk kanë përfunduar as sot marrëveshje të ndërsjella bashkëprodhimi. U quajti si një ide e mirë ajo që të lejohet zbatimi dypalësh i dispozitave të kësaj Konvente nga ato shtete që dëshirojnë të veprojnë në këtë mënyrë. Në procesin e hyrjes në këtë Konventë, ato shtete u japin kështu mundësinë prodhuesve të tyre që të përfshihen në bashkëprodhime me ortakë nga cilido shtet tjetër që ka ratifikuar këtë Konventë.

Së fundmi, duke autorizuar bashkëprodhimet me natyrë krejtësisht financiare, çka nënkupton bashkëprodhime pa pjesëmarrjen artistike dhe teknike nga bashkëprodhuesit më të vegjël, Konventa siguron një përgjigje ndaj bashkëprodhimeve tradicionale, në të cilat pjesët e kontributeve nga ortakë të ndryshëm shpesh çojnë në atë që është vlerësuar si "Europuddings – garnitura Europiane". Duke lënë që ortakët e shumicës të jenë të lirë që të kenë kontrollin e plotë teknik dhe artistik mbi veprën, ky lloj bashkëprodhimi nxit mbrojtjen e identiteteve kulturore individuale të vendeve të ndryshme europiane, duke plotësuar kështu një nga qëllimet e përcaktuara në Konventën Kulturore të Këshillit të Europës.

KOMENTE

Neni 1

Qëllimi i Konventës

Qëllimi i këtij neni është të përkufizojë dëshirën e Konventës, konkretisht, nxitjen e

bashkëprodhimeve kinematografike europiane.

Palët nuk dëshironin që ta shtrinin synimin e Konventës të veprat audiovizuale, sepse këto normalisht nuk rregullohen nga marrëveshjet e bashkëprodhimit të përfunduara ndërmjet shteteve. Si rrjedhim nuk ka nevojë që të harmonizohen rregullat ndërkombëtare në lidhje me to.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Konventa i referohet faktit se vetë kjo Konventë vendos rregulla të së drejtës ndërkombëtare, të cilat synojnë të rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve në lidhje me rregullimet për bashkëprodhimet kinematografike që përfshijnë prodhuesit nga të paktën dy shtete. Konventa gjithashtu mund të shërbejë si një marrëveshje dypalëshe ndërmjet dy vendeve, atëherë kur nuk është arritur asnjë marrëveshje dypalëshe bashkëprodhimi ndërmjet tyre dhe kur ato nuk kanë vendosur që të bëjnë një rezervim sipas nenit 20.

Është rënë dakord që fjalët "bashkëprodhimet shumëpalëshe që krijohen në territorin e Palëve" të mos nënkuptojnë që ekziston vetëm një certifikatë e vetme e origjinës, por që ekziston një për çdo shtet bashkëprodhues.

Palët janë ato që janë Palë në Konventë. Konventa mund të merret si referim vetëm nga prodhues të cilat janë shtetas të shteteve që janë Palë në Konventë. Këta prodhues duhet të japin prova të prejardhjes së tyre, çka nënkupton, të vendosjes së tyre në njërin nga shtetet palë të Konventës.

2. Kur Konventa zbatohet për një bashkëprodhim shumëpalësh, ajo mund gjithashtu të përfshijë bashkëprodhues të cilët janë të vendosur në vende që nuk janë Palë në Konventë, me kusht që bashkëprodhimi të përfshijë të paktën tre bashkëprodhues të vendosur në shtetet palë në Konventë dhe që ata bashkëprodhues të kontribuojnë për të paktën 70% të financimit të prodhimit. Me qëllim që të ketë përputhje me qëllimet e përcaktuara në nenin 1 të tekstit, konkretisht, nxitjen e bashkëprodhimeve europiane, u pa e nevojshme që të vendosej një kusht i përgjithshëm përzgjedhjeje në lidhje me origjinën europiane të veprës. Kriteret e përdorura për të përcaktuar një origjinë të tillë janë të përcaktuara në nenin 3 dhe në shtojcën 11, të cilat janë pjesë integrale e Konventës.

3. Në rastin e një bashkëprodhimi dypalësh, janë plotësisht të zbatueshme dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe. Në rastin e bashkëprodhimeve shumëpalëshe, dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet shteteve palë në këtë Konventë janë të zbatueshme vetëm në qoftë se ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës. Në rast se ka mospërputhje, janë drejtpërdrejt të zbatueshme dispozitat e Konventës dhe ato kanë përparësi mbi dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe që bien në kundërshtim me to.

Neni 3

Përkufizime

a) Përkufizimi i një "vepre kinematografike" riprodhon përkufizimin përgjithësisht të pranuar në marrëveshjet ekzistuese të bashkëprodhimit. Duke parë vështirësitë e shpërndarjes nëpër Europë, fakti që një bashkëprodhim kinematografik nuk shfaqet në ekranin e kinemasë nuk shkakton që ai të humbasë statusin e tij të bashkëprodhimit.

b) I takon secilës Palë që të përkufizojë statusin e një prodhuesi në përputhje me rregullat e përcaktuara për këtë qëllim nga vetë ato Palë. Si rregull i përgjithshëm, ndërmarrja e prodhimit duhet të jetë posaçërisht e përfshirë në prodhimin e veprave kinematografike çka përjashton, ndër të tjera, institucionet financiare.

Neni 4

Përfshirja në filmat vendas

1. Qëllimi kryesor i një marrëveshje bashkëprodhimi është që të japë për veprat kinematografike që mund të paraqesin një kërkesë të tillë, shtetësinë e secilit nga ortakët në bashkëprodhim. Veprat në këtë mënyrë, mund të përfitojnë nga ndihmat që i jepen në shkallë vendi industrisë kinematografike dhe shfaqjes së filmave. Ato mund të përfitojnë gjithashtu nga rregullat e brendshme në lidhje me prejardhjen/originën atje ku është fjala për transmetimin televiziv. Marrëveshjet e bashkëprodhimit mundësojnë gjithashtu shtrirjen e përfitimit të përjashtimeve nga taksat, përjashtime këto që jepen ndaj këtyre veprave në disa vende të caktuara. Veprat e bashkëprodhimit vendosen kështu në një hap me veprat kombëtare përsa i përket hyrjes dhe përparësive që kanë këto të fundit.

2. Veprat e bashkëprodhimit sidoqoftë, u nënshtrohen rregullave të brendshme që rregullojnë bashkëprodhimin kinematografik dhe hyrjen në gamën e ndihmave në vende të ndryshme që janë ortakë në bashkëprodhim. Për shkak të rregullit të mosdiskriminimit, një bashkëprodhim, edhe atje ku është një bashkëprodhim në pakicë, nuk mund të gëzojë një status të ndryshëm nga ai i bashkëprodhimit të shumicës.

Sidoqoftë, zbatimi i rregullave të brendshme kërkon në mënyrë të nënkuptuar prova të përputhshmërisë me dispozitat e kësaj Konvente (shih nenin 5) për ato bashkëprodhime që kërkojnë përfitime sipas saj. Ky deklaram është aktualisht rrjedhojë e sistemit të Konventës, i cili përcakton me hollësi kushtet në të cilat bashkëprodhimet në fjalë përfshihen në filmat vendas, me qëllim që ato të mund të përfitojnë nga përparësitë që siguron legjislacioni i brendshëm i vendeve të ndryshme që janë përfshirë si ortakë në bashkëprodhim.

Neni 5

Kushtet për të përfituar statusin e bashkëprodhimit

1, 2 dhe 5. Në përputhje me rregullin e përcaktuar në marrëveshje dypalëshe bashkëprodhimi, njohja e statusit të bashkëprodhimit kërkon këshillimin ndërmjet dhe miratimin nga autoritetet kompetente të çdo vendi. Qëllimi i këtyre formaliteteve është që të përcaktojë se bashkëprodhimi është në përputhje me rregullat e ravijëzuara në Konventë. Secila Palë përcakton autoritetin kompetent që do të jetë përgjegjës për zbatimin e Konventës. Një listë e autoriteteve të tilla do t'i transmetohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe do të përditësohet rregullisht nga Palët.

4. Për sa i përket njohjes së kualifikimeve të prodhuesve, duhet mbajtur në mendje se këto mund të jenë të njohura zyrtarisht në disa vende (me anë të një sistemi kartash identiteti profesional apo listash profesionale), por se kjo nuk është ajo që ndodh zakonisht. Qëllimi i dispozitës është para së gjithash që t'i ndalojë prodhuesit të cilët njihen gjerësisht se janë jokompetentë si dhe prodhuesit diletantë nga bërja e bashkëprodhimeve. Shoqëritë që ekzistojnë vetëm si emër ("letterbox" companies – shoqëritë që kanë vetëm kutinë postare), të krijuara thjesht për të ndihmuar në mbështetjen financiare të një projekti të dhënë shumëpalësh, duhet gjithashtu që të përjashtohen.

Neni 6

Pjesët e kontributeve nga secili bashkëprodhues

1. Marrëveshjet që janë aktualisht në fuqi përcaktojnë nivelet e pjesëmarrjes nga vendet që janë në pakicë në një luhatje nga 20% deri në 30%. Fondi Eurimages, nga ana tjetër, siguron një nivel pjesëmarrje të ulët deri në 10%. Sidoqoftë, kjo mundësi nuk i jep të drejtën një bashkëprodhimi që të përfitojë statusin vendas – kombëtar, nëse kufiri i vënë për Eurimages është më i ulët sesa ai i përcaktuar në marrëveshjet e përmendura më lart. Duke pasur parasysh numrin e madh të ortakëve të përfshirë në bashkëprodhimet shumëpalëshe, numër që domosdoshmërisht sjell dhe shoqërohet nga një ulje e pjesëmarrjes nga bashkëprodhuesit, u pa e përshtatshme që të miratohej një kufi minimal prej 10%, i cili do të bënte gjithashtu të mundur që të njëjtësoheshin rregulloret me praktikën e pranuar nga Eurimages. Nga ana tjetër, një pjesëmarrje prej më pak se 10% nuk mund të përshkruhet si bashkëprodhim, por zakonisht nënkupton thjesht një parablerje. Me këndvështrimin e ruajtjes së statusit të bashkëprodhimit, çka në thelb bashkon shumë ortakë në një punë të përbashkët, u propozua që pjesa e shumicës të ishte e kufizuar në 70%. Kufiri i pjesëmarrjes si shumicë vazhdon të jetë i pranueshëm edhe ndërmjet 70% dhe 80%, në rastin e një bashkëprodhimi dypalësh, por kjo përjashton përfshirjen e një bashkëprodhuesi të tretë.

Sidoqoftë, në rastin e një pjesëmarrje në pakicë me më pak sesa kufiri tradicional prej 20%,

me qëllim zgjidhjen e problemeve që lindin veçanërisht në vendet ku ndihma është e vetvetishme dhe e plotë për bashkëprodhuesin, pavarësisht nga pjesa vendase/kombëtare në bashkëprodhim, është përcaktuar se shteti i prejardhjes së bashkëprodhuesit në pakicë mund të ndërmarrë hapa që të kufizojë hyrjen drejt mekanizmave vendase për ndihma ndaj bashkëprodhimeve.

2. Atje ku janë në mes bashkëprodhime dypalëshe, 20% dhe 80% janë përqindjet zakonisht më të njohura në marrëveshjet që janë aktualisht në fuqi.

Neni 7

Të drejtat e bashkëprodhuesve

1. Duke qenë se synimi i bashkëprodhimit është që të ndajë të drejtat mbi negativin origjinal, negativi duhet t'i përkasë secilit nga bashkëprodhuesit. Me qëllim që të ruhen të drejtat e bashkëpronësisë të nënkuptuara nga bashkëprodhimi, secili bashkëprodhues duhet të jetë i aftë të ketë hyrje të lirshme te negativat, me qëllim që të jetë në gjendje të bëjë kopjet e nevojshme për shfrytëzimin e veprës.

2. Me qëllim që të lehtësohet shpërndarja, shpeshherë është e nevojshme që bashkëprodhuesi të ketë, për përdorimin e tij vetjak, një negativ të ndërmjetëm apo çfarëdolloj mjeti tjetër që mundëson riprodhimin e veprës. Kjo është një e drejtë nga e cila në disa raste hiqet dorë për arsye financiare. Në këtë rast, duhet të arrihet një marrëveshje ndërmjet bashkëprodhuesve të ndryshëm në lidhje me vendin në të cilin do të mbahet negativi origjinal.

Neni 8

Pjesëmarrja teknike dhe artistike

1. Duke mbajtur parasysh faktin që Konventa i njeh veprës së bashkëprodhuar shtetësitë e vendeve që janë ortakë në bashkëprodhim, kjo njohje e bashkëpronësisë duhet të pasqyrohet në një pjesëmarrje të vërtetë nga ana e personelit teknik dhe artistik të këtyre vendeve në prodhimin e filmit. Një pjesëmarrje e tillë bën të mundur që të krijohet një lidhje ndërmjet veprës së bashkëprodhuar dhe vendit, shtetësinë e të cilit do të përfitojë bashkëprodhimi. Kjo pjesëmarrje duhet logjikisht të jetë në përpjesëtim të drejtë me masën e pjesës së secilit vend ortak të bashkëprodhimit. Është e qartë se atje ku pjesëmarrja financiare nuk arrin të jetë në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen teknike dhe artistike, autoritetet kompetente mund ose të refuzojnë dhënien e statusit të bashkëprodhimit ndaj atij projekti, ose të tërhiqen nga marrëveshja e tyre paraprake. Ky rregull duhet të kuptohet nën dritën e detyrimeve ndërkombëtare të marra përsipër nga shtete të ndryshme palë në Konventë dhe veçanërisht, rregullat që lidhen me lëvizjen e lirë të punonjësve të përcaktuara në Traktatin e Romës. Përmbajtja e kushteve, si të atyre teknike ashtu edhe të atyre artistike, përcaktohet në shtojcën II.

2. Detyrimi, përveçse kur parashikohet ndryshe, për të përdorur teknikët dhe industrinë teknike të vendosura në vendet që janë ortakë në bashkëprodhim siguron që të bëhet e pamundur përdorimi i punonjësve apo industrive teknike që gëzojnë një shkallë më të ulët mbrojtjeje, jashtë kuadrit të një bashkëprodhimi. Teknikët e vendosur ligjërisht në vendet që janë ortakë në bashkëprodhim, do të quhet se janë shtetas të këtyre shteteve.

Për sa i përket fazës së pas-prodhimit, kjo nuk mund të kryhet në një vend i cili nuk është ortak në bashkëprodhim, përveç rastit kur mungojnë lehtësirat e përshtatshme teknike në ato vende.

Një shtet mund të përfshijë te banorët e tij edhe banorët e vendeve që i përkasin sferës së tij kulturore.

Neni 9

Bashkëprodhimet financiare

1. Ndërsa mbetet i ligjshëm parimi, i referuar në nenin 8, i një kontributi teknik apo artistik në përpjesëtim të drejtë me investimin financiar, shqetësimet në lidhje me identitetin dhe financimin e veprave kombëtare kanë çuar në mbajtjen e një metode alternative të montimit. Shpeshherë, parimi i një kontributi teknik apo artistik në përpjesëtim të drejtë me pjesën në financim mund të çojë drejt zgjidhjeve që marrin më shumë parasysh kërkesat e marrëveshjes së bashkëprodhimit sesa nevojat për një koherencë artistike. Për më tepër, nevojat financiare në rritje të bashkëprodhimeve europiane

nënkuptojnë që bashkëprodhimi po bëhet një model përgjithësisht i pranuar edhe në rastet e projekteve, frymëzimi i të cilave rrjedh vetëm nga një vend. Me qëllim që të merren parasysh nevojat e respektimit të identitetit kulturor se secilit nga shtetet palë si edhe koherenca e zgjedhjeve artistike të bashkëprodhuesve, është propozuar që modeli i bashkëprodhimit financiar, i cili për momentin pranohet vetëm nga një numër shumë i vogël marrëveshjesh dypalëshe, të bëhet modeli i përgjithshëm. Mbështetja tek dispozitat që rregullojnë bashkëprodhimet financiare nuk mjafton për përjashtim nga kushtet e përcaktuara në nenin 5 paragrafi 4, në lidhje me përfshirjen e bashkëprodhuesve në mirëbesim/bona fide. Për më tepër dhe veçanërisht atje ku bashkëprodhimi financiar jep të drejta të plota për të përfituar nga ndihmat ndaj bashkëprodhimeve tradicionale të përdorshme në nivel kombëtar, kushtet në lidhje me ekuilibrin e përgjithshëm, të përcaktuara në nenin 10 më poshtë marrin një rëndësi të veçantë.

a) Në lidhje me kërkesat e veçanta për bashkëprodhimet financiare, quhet se pjesëmarrja maksimale financiare nuk duhet të kalojë 25%, duke qenë se mund të arsyetohet se përtej këtij niveli, kontributi financiar i prodhimit teknik dhe artistik do të vijojë si rrjedhim i pritshëm. Një Palë është sidoqoftë e lirë që t'i shmanget këtij rregulli sipas kushteve të përcaktuara në nenin 20.1.

b) Del gjithashtu nga teksti se vetëm pjesëmarrjet në pakicë mund të përfitojnë përjashtim nga kushtet e përcaktuara në nenin 8 në lidhje me pjesëmarrjen artistike dhe teknike. Duke qenë se qëllimi i bashkëprodhimeve financiare është që të sigurojë respektimin e identiteteve kulturore, pjesëmarrja artistike dhe teknike nga ana e prodhuesve në shumicë është logjiksht më e madhe sesa aksionet e bashkëprodhuesve në bashkëprodhim.

d) Për më tepër, çdo bashkëprodhim financiar duhet të jetë i aftë që të paraqesë kontrata bashkëprodhimi, të cilat sigurojnë ndarjen e të ardhurave ndërmjet të gjithë bashkëprodhuesve. Kjo dispozitë vetëshpjeguese është veçanërisht e nevojshme që rastin e bashkëprodhimit financiar, me qëllim që të shmanget pjesëmarrja e institucioneve thjesht financiare të cilat nuk marrin pjesë në rreziqet dhe përfitimet e prodhimit. Atje ku përmbushen këto kushte, bashkëprodhimet financiare mund të jenë një mjet veçanërisht i përshtatshëm për zhvillimin e identiteteve kulturore europiane. Në fakt, duke vënë në lëvizje burime të rëndësishme financiare nga shumë vende europiane e duke respektuar në të njëjtën kohë identitetin kombëtar të prodhuesit në shumicë, i cili është forca e vërtetë shtytëse artistike për këtë vepër, ato do të japin një kontribut të qenësishëm për shprehjen e kulturave të mirëfillta kombëtare.

2. Kushtet për autorizimin e bashkëprodhimeve financiare (të cilat luhaten sipas rastit) mund t'i japin shtysë marrëveshjeve individuale ndërmjet shteteve.

Neni 10

Ekuilibri i përgjithshëm ndërmjet Palëve

1 – Qëllimi i Konventës është zhvillimi i industrisë kinematografike në secilin nga shtetet e saj palë. Zhvillimi i bashkëprodhimeve është një nga mjetet më efikase dhe të përshtatshme për atë qëllim. Sidoqoftë, zhvillimi i bashkëprodhimeve tradicionale ose financiare, në disa raste, mund të çojë drejt një mungese të ekuilibrit ndërmjet një vendi dhe një apo më shumë prej ortakëve të tij në një periudhë kohe të dhënë. Duke qenë se në shumicën e vendeve të Europës industria kinematografike merr ndihma financiare të një natyre thelbësore për të nga fondet publike, shqetësimi i shteteve për të ruajtur kulturën e tyre është më se i ligjshëm. Kjo është arsyeja pse u quajt e nevojshme që në tekst të futet koncepti i një ekuilibri të përgjithshëm ndërmjet Palëve, çka duhet të jetë e zbatueshme në mënyrë të njëjtë si për bashkëprodhimet tradicionale ashtu edhe për ato financiare. Nuk mund të jetë pjesë e qëllimit të Konventës që një fond vendas të përdoret për të kontribuar për sipërmarrjet kinematografike të shteteve të tjera, kur nuk ka reciprocitet të mjaftueshëm. Është e domosdoshme që shteteve t'u lejohet njëfarë lirie veprimi në interpretimin e konceptit të reciprocitetit, duke pasur në mendje se fryma e Konventës bën thirrje për një vlerësim të hapur dhe të luhatshëm të atij parimi.

2. Atje ku një Palë sheh se ka mungesa në marrëdhëniet e saj të bashkëprodhimit me një apo më shumë palë të tjera, këto mungesa mund të marrin një sërë formash:

– një shtet mund të vëzhgojë se ka një mungesë të theksuar të ekuilibrit ndërmjet rrjedhës së investimeve të brendshme për të financuar filma të huaj dhe rrjedhës së investimeve të huaja për të financuar industrinë e vet të filmit;

– ai mund të vërë re gjithashtu se ka një mungesë të ekuilibrit në një periudhë të dhënë mes numrit të bashkëprodhimeve në shumicë dhe bashkëprodhimeve në pakicë me një apo më shumë

vende ortake;

– së fundmi, mungesa e ekuilibrit mund të marrë formën e një marrëdhënie të ndërsjellë, për shkak të përdorimit të regjisorëve dhe personelit teknik e artistik nga njëra anë dhe numrit të bashkëprodhimeve në shumicë e në pakicë nga ana tjetër.

Sidoqoftë, autoriteti kompetent duhet të refuzojë dhënien e statusit të bashkëprodhimit vetëm si mundësi e fundit, pasi të jenë kaluar kanalet/hapat e zakonshëm të këshillimit midis Palëve të interesuara.

Neni 14

Gjuhët

Në lidhje me gjuhën e variantit origjinal, është e kuptueshme që fryma e Konventës, qëllimi i së cilës është të nxisë shfaqjen e bashkëprodhimeve që pasqyrojnë identitetin europian, gjë e cila varet në shprehjen e një identiteti të mirëfilltë kombëtar, është qartësisht në favor të përdorimit të gjuhës që është më e përshtatshme për të punuar nga ana kulturore.

Zgjedhja e xhirimit të një filmi në një gjuhë, e cila nuk lidhet me kërkesat e skenarit thjesht për arsye tregtare, me shpresën – shpesh të besuar nga fakti i depërtimit në “tregun botëror”, është haptazi në kundërshtim me qëllimin e vërtetë të Konventës.

Megjithatë, nuk është parë e mundshme që kjo kërkesë të formalizohet në Konventë në formën e një rregulli ligjor. Arsyeja për këtë është se gjuha e cila vlerësohet si e përshtatshme nga ana kulturore mund të përkufizohet në shumë mënyra. Ajo përgjithësisht përkufizohet si gjuha e njërit nga vendet që merr pjesë në bashkëprodhim; por në një bashkëprodhim trepalësh, nëse gjuha e përdorur është ajo e një bashkëprodhuesi pjesa e të cilit është vetëm 10% e që nuk ka siguruar as regjisorin e filmit, as aktorët e as skenarin, kjo gjë është qartësisht artificiale. Bërja formale e kërkesës për përdorimin e gjuhës së vendeve bashkëprodhuese, në këto rrethana, mund të nxisë shtimin e bashkëprodhimeve "ad hoc" – posaçërisht për këtë qëllim.

Në fakt, gjuha më e përshtatshme e variantit origjinal duket se është ajo që mund të përkufizohet si "gjuha natyrale e treguesit", gjuha në të cilën personazhet do të flisnin natyrshëm sipas kërkesave të skenarit. Gjuha e treguesit, e përcaktuar në këtë mënyrë, mund të mos ketë asnjë lidhje me strukturën financiare të përdorur nga bashkëprodhimi, çka nënkupton që nuk mund të ketë një përkufizim ligjor të asaj gjuhe.

Për këtë arsye u duk më e preferuar që shtetet palë të Konventës të lireshin tërësisht të lira në këtë pikë me qëllim që ato të mund të përcaktonin pritshmërinë e vet në këtë çështje.

Si pasojë, neni 14 thjesht siguron që, me qëllim mundësimin e një filmi për t'u shpërndarë në të gjitha vendet që e kanë prodhuar atë, vendet e kërkuara mund të kërkojnë paraqitjen e njërit variant përfundimtar në gjuhën e tyre, qoftë me dublim apo me nëntitra, në varësi të zakoneve kulturore të secilit vend. Në përputhje me dispozitat e nenit 4, neni 14 nuk shteron mundësinë e një shteti palë në Konventë që të vendosë rregulla gjuhësore, në lidhje me mundësinë e përfitimit nga disa sisteme ndihme, me kusht që rregullime të tilla të mos jenë diskriminuese në lidhje me shtetësinë e filmit.

Nenet 16 deri 22

Dispozitat përmbyllëse të Konventës janë hartuar sipas modelit të dispozitave përmbyllëse për konventat dhe marrëveshjet e përfunduara brenda Këshillit të Europës, siç janë hartuar ato nga Komiteti i Ministrave.

Në përputhje me nenet 16 dhe 18, Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe nga shtetet e tjera palë në Konventën Kulturore Europiane, si edhe për hyrje nga shtetet e tjera europiane joanëtare. Synimi gjeografik i Konventës pasqyron në këtë mënyrë qëllimin e Këshillit të Europës, konkretisht zhvillimin e bashkëprodhimeve kinematografike europiane.

Neni 20 lejon vetëm dy rezervime, njëri lidhur me moszbatimin e nenit 4 paragrafi 2 të Konventës për marrëdhëniet e bashkëprodhimit dypalësh të shtetit që bën rezervimin me një apo më shumë Palë, kurse tjetri lidhet me lejimin e një shteti për të përcaktuar kufirin maksimal të pjesëmarrjes në pakicë sipas kufizimit në kontributin financiar, në një mënyrë tjetër nga ajo e parashikuar në nenin 9 paragrafi 1.a.

SHTOJCA I

Shtojca 1 përcakton me hollësi ato praktika që rrjedhin nga dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe e që kanë dhënë në të vërtetë prova se ato i përshtaten veçanërisht më së miri synimit të tyre.

SHTOJCA II

Duke pasur parasysh se qëllimi i kësaj Konvente është krijimi i veprave kinematografike europiane, u quajt e nevojshme që të përcaktohej ky koncept në mënyrën më të paanshme të mundshme, duke përdorur kriterin e prejardhjes europiane të pjesëmarrësve në bashkëprodhim. Kjo interpretohet në kuptimin e vet të gjerë, ndërsa i referohet vendosjes së bashkëpunëtorëve të një veprë në një nga vendet e territorit gjeografik të Europës, pa diskriminim ndërmjet vendeve që janë nënshkruese në Konventë dhe vendeve të tjera europiane.

Tabela e pikëve që përmbahet në shtojcën II nuk ka për qëllim të përjashtojë veprat e bashkëprodhuara nga dispozitat e nenit 8 në lidhje me pjesëmarrjen teknike dhe artistike të ortakëve të ndryshëm në bashkëprodhim. Ajo thjesht përbën një kusht të nevojshëm, por jo të mjaftueshëm për të bërë përzgjedhjen për statusin e bashkëprodhimit.

Shtojca ndahet në tre grupe të një rëndësie pak a shumë të njëjtë, megjithëse aty nuk përmenden prodhuesit duke qenë se, sipas dispozitave të nenit 2 të Konventës, vepra e bashkëprodhuar europiane është domosdoshmërisht e kontrolluar nga bashkëprodhuesit e vendosur në një nga Palët në Konventë. Tabela e pikëve përcakton me hollësi bashkëpunëtorët e një veprë të ndarë në tri njësi: njësia krijuese, ajo e aktorëve dhe njësia teknike. Në njësinë e parë i jepet e njëjta rëndësi regjisorit dhe skenaristit. Për sa i përket skenarit, është e kuptueshme që tri pikët mund të shpërndahen mbi bazën e shtetësisë së secilit, ndërmjet krijuesit të idesë origjinale, përshtatësit dhe shkruesit të dialogëve. Për sa i përket njësisë së aktorëve, llogaritja e numrit të pikëve bazohet në ditët që aktualisht kanë qenë të pranishëm gjatë xhirimeve. Së fundmi, në lidhje me grupin e mbështetjes teknike, pika i jepet studios dhe vetëm atje ku nuk ka një studio merret parasysh vendndodhja.

LIGJ

Nr.10 038, datë 22.12.2008

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR TAKSIMIN E MJETEVE RRUGORE NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën për taksimin e mjeteve rrugore në transportin ndërkombëtar të mallrave, bërë në Gjenevë më 14 dhjetor 1956.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5996, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

E/EC/262
E/ECE//TRANS/496

KONVENTA

MBI TAKSIMIN E MJETEVE RRUGORE
NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE
Bërë në Gjenevë më 14 dhjetor 1956

KOMBET E BASHKUARA
Gjenevë, shkurt 1957

CE.93-245

KOMISIONI EKONOMIK PËR EUROPE
SEKTORI I TRANSPORTIT

Palët Kontraktuese,
duke kërkuar të lehtësojnë transportin ndërkombëtar të mallrave me rrugë,
kanë rënë dakord si vijon.

Neni 1

Për qëllime të kësaj Konvente:

- a) Termi “mjete” do të ketë parasysh të gjitha mjetet rrugore vetëlëvizëse dhe të gjitha rimorkiot që lidhen me këto mjete, qoftë të importuara bashkë me mjetin, ose të importuara më vete;
- b) Termi “transporti ndërkombëtar i mallrave” do të ketë parasysh transportin tregtar ose industrial të mallrave me ose pa pagesë, kur rruga e ndjekur kalon të paktën përmes një kufiri midis dy shtetesh;
- c) Termi “taksa apo tatime mbi transportin” do të ketë parasysh:
 - taksat mbi xhiron dhe taksa të njëjta, si për shembull taksa mbi vlerën e shtuar;
 - tarifatat për lëshimin e licencave të transportit, ose dokumente të tjera të nevojshme;
 - taksat ose taksat suplementare për t'u paguar për këtë veprim transporti, plus dhe mbi taksat e caktuara vetëm mbi të drejtën e mbajtjes së mjetit dhe përdorimit të tij në rrugë.

Neni 2

Mjetet që regjistrohen në territorin e një prej Palëve Kontraktuese dhe që përdoren nën regjimin e importit të përkohshëm gjatë kryerjes së transportit ndërkombëtar të mallrave në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese, sipas kushteve të paraqitura më poshtë, do të përjashtohen nga taksat dhe tatimet e vendosura mbi qarkullimin ose qëndrimin e mjetit në territorin e asaj Pale Kontraktuese. Ky përjashtim nuk do të zbatohet për pagesat, taksat apo tatimet mbi konsumin ose taksat apo tatimet mbi transportin.

Neni 3

1. Ky përjashtim do të lejohet në territorin e çdo Pale Kontraktuese sa kohë që përmbushen kushtet e paraqitura në rregulloren doganore në fuqi të atij territori, për lejimin e përkohshëm pa pagesën e tarifave doganore dhe të taksave të importit të mjeteve të përcaktuara në nenin 2, si dhe sa kohë që përmbushen kushtet e paraqitura në rregulloret në fuqi për autorizimin e këtij transporti.
2. Megjithatë, çdo Palë Kontraktuese mund të përjashtojë nga përfitimi i këtij përjashtimi çdo mjet, që ajo mund të autorizojë për përdorim transporti, kur edhe pikat e nisjes, edhe ato të mbërritjes ndodhen brenda territorit të saj.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 4

1. Vendet anëtare të Komisionit të Ekonomisë për Europën dhe vendet e pranuar në këtë Komision si palë konsultative, sipas paragrafit 8 të termave të referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Konvente:
 - a) duke e nënshkruar atë;

- b) duke e ratifikuar atë, pasi kanë nënshkruar duke marrë parasysh ratifikimin;
 - c) duke aderuar në të.
2. Këto vende, që marrin pjesë në aktivitete të caktuara të Komisionit të Ekonomisë për Europën, në përputhje me pikën 11 të termave të referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese e kësaj Konvente duke aderuar në të pas hyrjes së saj në fuqi.
3. Konventa do të jetë e hapur për nënshkrim deri më dhe përfshirë datën 18 maj 1957. Pas kësaj date, ajo do të jetë e hapur për aderim.
4. Ratifikimi ose aderimi në të, realizohet me anë të depozitimit të një instrumenti te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 5

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas nënshkrimit të saj nga pesë vendet e përmendura në nenin 4 paragrafi 1, pa kushtin e ratifikimit ose depozitimit të instrumenteve të tyre të ratifikimit ose aderimit.
2. Për çdo vend që e ratifikon ose aderon në të, pasi të pestë vendet ta kenë nënshkruar atë pa kushtin e ratifikimit ose depozitimit të instrumenteve të tyre të ratifikimit ose aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë, pasi vendi i përmendur të ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 6

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
2. Denoncimi do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë muaj nga data e marrjes së njoftimit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 7

Kjo Konventë do të pushojë së qeni në fuqi, nëse, për dymbëdhjetë muaj në vazhdim, pas hyrjes së saj në fuqi, numri i Palëve Kontraktuese është më i vogël se pesë.

Neni 8

1. Çdo vend, në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente pa kushtin e ratifikimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, ose aderimit, ose në çdo periudhë të mëvonshme, mundet të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se kjo Konventë do të shtrihet te të gjitha ose çdo territor, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është përgjegjës. Konventa do të shtrihet në territorin ose territoret e përmendura në njoftim nëntëdhjetë ditë pas marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm, ose, nëse në atë ditë kjo Konventë nuk ka hyrë ende në fuqi, në kohën kur ajo hyn në fuqi.
2. Çdo vend që ka bërë një deklaratë sipas paragrafit të mësipërm, duke e shtrirë këtë Konventë në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është përgjegjës, mund ta denoncojë Konventën veçmas për atë territor, në përputhje me dispozitat e nenit 6.

Neni 9

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, për sa të jetë e mundur, duhet të zgjidhet me anë të negociatave midis tyre.
2. Çdo mosmarrëveshje, që nuk zgjidhet me anë të negociatave, duhet të dërgohet për arbitrim, nëse një nga Palët Kontraktuese në konflikt e kërkon këtë, dhe do t'i paraqitet sipas rrethanave një ose më shumë arbitrave, të zgjedhur me marrëveshje nga Palët në konflikt. Nëse, brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrim, Palët në konflikt nuk bien dakord për zgjedhjen e arbitrit ose arbitrave, një nga Palët Kontraktuese mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të

emërojnë një arbitër të vetëm, të cilit do t'i paraqitet çështja për vendim.

3. Vendimi i arbitrit ose arbitrave, të caktuar sipas paragrafit të mësipërm, është detyrues për Palët Kontraktuese në konflikt.

Neni 10

1. Çdo Palë Kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Konventë, mund të deklarojë që nuk e konsideron veten të detyruar prej nenit 9 të Konventës. Palët e tjera Kontraktuese nuk do të jenë të detyruara prej nenit 9, në raport me çdo Palë Kontraktuese që ka një kusht të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese që ka një kusht siç parashikohet në pikën e mësipërme, mundet ta tërheqë këtë kusht në çdo moment duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Nuk do të lejohet asnjë kusht tjetër ndaj kësaj Konvente.

Neni 11

1. Pas qëndrimit në fuqi të kësaj Konvente për tre vjet, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë mbledhjen e një konference me qëllim rishikimin e Konventës, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për kërkesën dhe një konferencë rishikimi do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një periudhe katërmujore pas datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se një e treta e Palëve Kontraktuese e njofton atë për aprovimin e kërkesës nga ana e tyre.

2. Nëse një konferencë mbledhet në përputhje me paragrafin e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha Palët Kontraktuese dhe i fton ata të dorëzojnë, brenda një periudhe tre mujore, ato propozime që ata do të dëshironin për t'u marrë në shqyrtim nga Konferenca. Sekretari i Përgjithshëm duhet të qarkullojë tek të gjitha Palët Kontraktuese një program provizor të Konferencës, së bashku me tekstet e këtyre propozimeve, të paktën tre muaj para datës, në të cilën do të mbledhet Konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në çdo Konferencë të mbledhur në përputhje me këtë nen të gjitha vendet e përmendura në nenin 4 paragrafi 1, dhe vendet që janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 4 paragrafi 2.

Neni 12

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë Konventë. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do të transmetohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ua transmetojë të gjitha Palëve Kontraktuese dhe njoftojë të gjitha vendet e tjera të përmendura në nenin 4 paragrafi 1.

2. Çdo amendament i propozuar, që qarkullohet në përputhje me pikën e mësipërme do të gjykohet i pranuar, nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk shpreh ndonjë kundërshtim brenda një periudhe gjashtëmujore pas datës së qarkullimit nga Sekretari i Përgjithshëm të amendamentit të propozuar.

3. Sekretari i Përgjithshëm, sa më shpejt që të jetë e mundur, njofton të gjitha Palët Kontraktuese, nëse është shprehur ndonjë kundërshtim për amendamentin e propozuar. Nëse është shprehur një kundërshtim për amendamentin e propozuar, amendamenti do të gjykohet i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë fuqi ligjore. Nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese tre muaj, pas skadimit të periudhës gjashtëmujore, të përcaktuar në pikën e mësipërme.

Neni 13

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenet 11 dhe 12, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njofton shtetet e përmendura në nenin 4 paragrafi 1, dhe vendet që janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 4, paragrafi 2, për:

a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet, sipas nenit 4;

b) datat e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 5;

- c) denoncimet sipas nenit 6;
- d) shfuqizimin e kësaj Konvente, në përputhje me nenin 7;
- e) njoftimet e mara, në përputhje me nenin 8;
- f) deklaratat dhe njoftimet e mara, në përputhje me nenin 10, paragrafët 1 dhe 2;
- g) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti, në përputhje me nenin 12.

Neni 14

Pas datës 18 maj 1957, kopja origjinale e kësaj Konvente do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do të dërgojë kopje të certifikuara të origjinalit tek secili prej vendeve të përmendura në nenin 4, paragrafi 1 dhe 2.

Në dëshmi të kësaj, i poshtëshënuari, duke qenë plotësisht i autorizuar, ka nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më katërmëdhjetë dhjetor, njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë, në një kopje të vetme në anglisht dhe frëngjisht; secili tekst është njëlloj i barasvlershëm me origjinalin.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.1.2009
Doli nga shtypi më 15.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë